

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		21.04	20.21
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	060/01	15004	

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 14.04.2021

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 1

Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒

Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 16

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☐

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da ☒ *KFOR-LMT K9*

Jo / Ne ☐

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së fundit të mbajtur më 05.02.2021,
Linku: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2021/02/Procesverbali-i-Mbledhjes-se-KKSBB-se-05.02.2021-orari-dhe-plani-i-punes.pdf>
2. Njoftim për situatën epidemiologjike në Komunën e Drenasit dhe vaksinimin e stafit shëndetësor;
3. Informim lidhur për masat e reja kufizuese dhe përgatitjet për mësimin në distancë;
4. Diskutim për qentë endacakë;
5. Të ndryshme.

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Procesverbali i mbledhjes së fundit të mbajtur me datën 05.02.2021 është miratuar pa vërejtje.

Për pikën e dytë, për njoftimin e situatës epidemiologjike në Komunën e Drenasit dhe vaksinimin e stafit shëndetësor dhe atyre të moshuar, ka informuar të pranishmit, drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Arsim Haxhiu, i cili ka thënë se për dallim nga komunat tjera, Drenasi qëndron më mirë në aspektin e të prekurve nga virusi Covid-19, por megjithatë kujdesi duhet të jetë i shtuar në mënyrë që të parandalohet virusi. Ai ka thënë se është mobilizuar i gjithë stafi, përkundër disa vështirësive me stafin mungesë. Haxhiu ka thënë se që nga rastet e para të vitit të kaluar, deri më tani kemi të prekur 1692 persona, ndërsa aktiv deri më tani kemi 124 persona dhe të shëruar 1506 persona. Ndërsa sa i përket vaksinimit, ka thënë se QKMF-ja ka pranuar gjithsej 450 doza të vaksinës, 100 për stafin shëndetësor dhe 350 për të moshuar mbi 80 vjeç. Prej tyre, 30 punëtorë shëndetësorë e kanë marrë deri më tani vaksinën dhe 102 persona mbi moshën 80 vjeç.

Për pikën e tretë, drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka ka informuar anëtarët e KKSB-së për masat e reja kufizuese dhe zhvillimin e mësimi në distancë. Gjoka ka treguar se ndonëse si komunë nuk janë pajtuar me masat e Qeverisë, megjithatë ato janë zbatuar. Ai ka shtuar se në të gjitha shkollat është duke u mbajtur mësimi online përmes platformës së ofruar falas nga Flutura Academy, ndërsa në ato nga klasa 1 deri në të 5 mësimi është duke u mbajtur në prani fizike.

Për pikën katërt lidhur me diskutimin për qentë endacak, ka treguar për gjendjen drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapit. Ndër të tjera ajo tha se deri më tani kjo ka qenë nën autoritetin e AVUK-ut dhe përkundër kërkesave të saj për numrin e saktë të qenve të trajtuar nuk ka marrë përgjigje.

Në secilën pikë, anëtarët e KKSB-së, kanë bërë pyetje dhe kanë diskutuar lidhur me situatën epidemiologjike, lidhur me problemet që po shfaqën më nxënës që nuk kanë mundësi të kyçen në mësimin online si dhe me problemet me qentë endacak.

Në pikën të ndryshme, nuk pati tema për diskutim.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori e KKSB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arben Shala
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovci

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 20.04.2020

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		07.04.2021	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	069/01-15004		



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



Data: 07.04.2021

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9, pika 1.3, dhe Vendimit nr. 12-030-786, të datës 04.01.2018, të Kuvendit Komunal, thirrret mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), dhe në emër të Kryetarit të Komunës, Ramiz Lladrovci, ju drejtojmë këtë:

F T E S Ë

Për anëtarin/en _____, nga _____, që të marrë pjesë në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), lidhur me zhvillimet në Komunën e Drenasit.

Mbledhja e rregullt do të mbahet më datën 14.04.2021, ditë e mërkurë, me fillim në orën 14:00, në Sallën e Kuvendit në Drenas.

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së fundit të mbajtur më 05.02.2021,
 Linku: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2021/02/Procesverbali-i-Mbledhjes-se-KKSBB-se-05.02.2021-orari-dhe-plani-i-punes.pdf>
2. Njoftim për situatën epidemiologjike në Komunën e Drenasit dhe vaksinimin e stafit shëndetësor;
3. Informim lidhur për masat e reja kufizuese dhe përgatitjet për mësimin në distancë;
4. Diskutim për qentë endacakë;
5. Të ndryshme.

Kopje: Anëtarëve të KKSBB-së



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci